



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 29-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 25.09.2024, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10<sup>00</sup>

### Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

### Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Shkelzen Hajdini
3. Burim Rrustemi, DSHPMM
4. Rexhep Rexhepi, DBPZHR

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës se bashku me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

## REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 28-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2025-2027.

3.Raporti Janar- Qershor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.

4.Raporti i Performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2023.

5.Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-9.

6.Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-15.

7.Raporti monitorues për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit, për periudhën 03.07.2023 - 03.07.2024.

8.Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan (Rishqyrtim).

9.Propozim Vendim për miratimin e Planit të orareve të rendeve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2024-2028 (Rishqyrtim).

10.Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës – IADK.

Pastaj kryesuesi tha se e kemi dhe një pike shtesë, Raporti i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e Projekt Buxhetit për vitet 2025-2027

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës me pikën shtesë dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 6 vota për Aprovoi rendin e ditës:

## I

### **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 28-të e KPF-së**

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 6 vota për Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 28-të të KPF-së

Kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, tha se propozoj qe raportet te kalojne direkt per kuvend, pikat 3,4,7,11.

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim propozimin.

Pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimsht me 6 vota per Aprovoi Propozimin.

## II

### **Propozim Vendim mbi aprovimin e Buxhetit per vitet 2025-2027.**

Lidhur me kete pike kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se a ka rritje te buxhetit per mirembajtje pasi qe e pat permend kryetari ke Kuvend, nese po sa eshet shuma.

Latif Ramadani, tha se po kemi rritje te te hyrave te mirembaje mbi 1 milion euro.

Pastaj Kryesuesi vuri ne votim kete pike et shkoj ne kuvend dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 6 vota per aprovoi propozimin.

## V

### **Propozim Vendim per miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-9.**

Lidhur me kete pike kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor DBF së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqe diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri ne votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 6 vota per aprovoi propozimin

## VI

### **Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-15.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor DBF së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 6 vota për aprovoi propozimin

## VIII

### **Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan (Rishqyrtim).**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS-së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ky propozim është maltretim për anëtarët e kuvendit pasi qe ky statut një here kthehet rishqyrtim për një nen, neni 11 pastaj herën e dyte edhe për disa nene tjera kjo nuk është ne rregull. Dhe secila komune i ka specifikat e veta.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se kur na eshët kthyer herën e pare vetëm per nje nen kemi llogarit qe janë shqyrtuar edhe nenin tjera janë ne rregull, ndërsa herën e dyte na kthehen disa nene tjera dhe kjo nuk është ne rregull, dhe ne kemi kontaktuar me ministri na kane thëne qe nuk e kemi dite qe është rishqyrtuar një here.

Shkelezen Hjadini, tha se ne jemi munduar qe ta modifikojmë ne baze te udhëzimit, edhe herën e pare edhe te dytën ,mirëpo si duket ministria nuk eshët qe ka shikuar te gjithën por vetëm te disa nene edhe pse na e kemi formën unë pavarësisht se secila komunë i ka specifikat e veta.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 6 vota për aprovoi propozimin

## IX

### **Propozim vendim për miratimit të planit të orarit të rrethave të udhëtimeve për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemi DSHPMM, i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Arsim Jashari, tha unë e kam lexuar mire dhe e kam analizuar dhe nuk e kam kuptuar çka ka dashtë me thanë ministria me këtë edhe pse jam goxha mirënjohës i kësaj fushe.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë 6 vota për, aprovoi propozimin.

## X

### **Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës – IADK.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:45

*Ekstraktin e hartoi*

*Behar Aliu*

*Kryesuesi i Komitetit*

*Daut Azemi*